

Manuali për Përdorimin e CREDINS *online* SMS

Përmbajtja

Përmbajtja	1
Figurat	2
1.0 Disa fjalë për Manualin	3
1.1 Termat bazë	3
2.0 Kushtet e përdorimit	3
2.1 Telefoni celular	4
2.2 Llogaria në bankë	4
2.3 Regjistrimi në sistem	5
2.4 Ndryshimi i parametrave të aplikimit Credins online SMS	5
2.5 Ç'rregjistrimi nga sistemi Credins online SMS	5
3.0 Funkionimi	6
3.1 Alarmet	6
3.2 Informacionet mbi gjëndjen dhe tre transaksionet e fundit	8

Figurat

Figura 01: ALARMI - Gjëndja mbi 10.000 LEK	7
Figura 02: ALARMI - Hyrjet mbi 5.000 LEK	7
Figura 03: ALARMI - Daljet mbi 1.000 LEK	7
Figura 04: ALARMI - Gjëndja në orën 16:45.....	8
Figura 05: GJËNDJA - Pëdoruesi dërgon fjalën kyçe BALANCECDIS.....	8
Figura 06: GJËNDJA - Banka i përgjigjet kërkesës së saktë.....	9
Figura 07: GJËNDJA - Pëdoruesi dërgon fjalën kyçe të pasaktë	9
Figura 08: GJËNDJA - Kërkesë e Panjohur	9
Figura 09: GJËNDJA - Personi nuk është i regjistruar	10
Figura 10: GJËNDJA - Personi i parregjistruar	10

1.0 Disa fjalë për Manualin

Ky manual ndihmon në shfrytëzimin më të mirë të aplikimit Credins online SMS. Këtu shpjegohen hap pas hapi të gjitha funksionet e programit. Informacionet shtesë janë dhënë në ekranet speciale, të cilat ju tërheqin vërejtjen për gabimet apo parregullsitë e mundshme gjatë përdorimit. Informacionet e dhëna në këtë manual mund të përmbajnë gabime teknike apo gabime shtypi dhe janë objekt i ndryshimeve të herë pas herëshme.

1.1 Termat bazë

Credins online SMS është një aplikim për klientët e bankës për të operuar me llogarinë e tyre. Credins online SMS ofron këto funksione:

- Informacionet për gjendjen e llogarisë dhe tre transaksionet e fundit (sipas kërkesës);
- Mundësinë për informacione për ndryshimet në llogari (automatike);
- Gjendja e llogarisë është më e lartë/më e ulët se një shumë e përcaktuar;
- Hyrjet/daljet e fondeve në llogari janë më të larta se një shumë e përcaktuar;
- Informacionet mbi gjendjen e llogarisë në një kohë të përcaktuar;
- Gjenerimin dhe dërgimin e mesazheve individuale informative dhe promovionale.

Sistemi **Credins online** përfshin aktivitetet bankare elektronike (E-bank) për pagesa vendore dhe ndërkombëtare.

Poseduesi i llogarisë të një banke elektronike (e-bank) është një pronar i një apo më shumë llogarive të një banke e cila është e përfshirë në transaksione elektronike (e-transaksione) dhe menaxhohet nga personat e autorizuar.

Përdoruesi është personi i cili është i autorizuar nga banka për të pëdorur një ose më shumë llogari të një poseduesi të llogarive. Një pronar i llogarisë mund të ketë disa persona të autorizuar.

2.0 Kushtet e përdorimit

Për të pëdorur shërbimin Credins online SMS, është e nevojshme t'i përmbahemi kushteve në vijim:

- Telefoni celular duhet të ketë të aktivizuar shërbimin SMS,
- Duhet të jeni pronar i llogarisë/person i autorizuar,

- Duhet të keni llogari të regjistruar në sistemin Credins online,
- Duhet të regjistroheni në sistemin Credins online SMS.

2.1 Telefoni celular

Telefoni celular duhet të suportoje teknologjinë GSM dhe shërbimet SMS (pranimi/krijimi/editimi/dërgimi i mesazhve SMS). Në çdo SMS, duhet të shihet numri i dërguesit, në të kundërt, përdoruesi nuk mund të identifikohet. Aplikimi mbështetet në shërbimin SMS, të cilat mund të përbëhen deri në 160 karaktere maksimalisht dhe nuk funksionon me shërbimin MMS (më shumë SMS të përmbledhura në një tërësi (p.sh. 5), fotografi, melodi, etj.). Kur dërgohen SMS nga tipet më të reja të telefonave celularë, duhet të kihet parasysh që SMS-të të mos jenë më të gjata se 160 karaktere dhe të fshihen të gjitha komentet e shtuara nga telefoni (rasti gjatë editimit të SMS-ve, p.sh. »Përcjellë SMS«, telefoni Sony Ericsson P900 e shton komentin “Përcjellë nga...”).

Për pranimin/dërgimin e SMS është e domosdoshme të vendosen parametrat e mëposhtem (vlerat e disa parametrave varen nga operatori i telefonisë celulare, shpesh kjo është në menynë SMS, opsioni “Rregullimi i mesazheve”):

- Numri i qendrës së mesazheve, i cili shpesh është i vendosur në kartë kur blihet karta SIM. Nëse nuk është i vendosur, ju duhet të telefononi operatorin e telefonisë celulare dhe të kërkonti këtë numër e pastaj ta aktivizoni atë në telefon.
- Vlefshmëria e mesazhit – preferohet të vendoset koha në maksimum.

Vlefshmëria e mesazhit përcakton periudhën kohore brenda së cilës mesazhi do të jetë i vlefshëm (nëse nuk është dërguar herën e parë, ajo mund të dërgohet gjatë këtij intervali kohor, e pas kësaj, mesazhi fshihet), ky parametër merret parasysh nga operatori i telefonisë celulare. Operatori i telefonisë celulare gjithashtu mund të përcaktojë këtë kohë nëpërmjet centralit (shembull: Përdoruesi zgjedh vlerën maksimale kohore, operatori i telefonisë celulare e ka përcaktuar vlerën maksimale kohore në p.sh. 7 atëherë koha maksimale do të jetë 7 ditë).

Konfirmimi i mesazhit – nëse përdoruesi zgjedh Po, ai do të marrë raportin nëse mesazhi u dërgua apo jo. Meqenëse mund të ndodhë që mesazhi SMS nuk është dërguar në qendrën e mesazheve SMS të operatorit të telefonisë celulare, apo që qendra SMS nuk arrin ta dërgojë atë mesazh tek pranuesi i fundit – zgjedhja e këtij opsioni ‘Po’ i mundëson përdoruesit të informohet nëse mesazhi SMS është dërguar.

2.2 Llogaria në bankë

Në mënyrë që përdoruesi të jetë në gjendje t’i shfrytëzojë shërbimet e aplikimit

Credins online SMS, ai duhet të jetë ose pronar (zotërues) i llogarisë ose të jetë i autorizuar të operojë me atë llogari.

2.3 Regjistrimi në sistem

Kur përdoruesi ka autorizim të operojë me llogarinë, hapi vijues është të regjistrohet në sistemet Credins online dhe Credins online SMS. Përdoruesi regjistrohet duke plotësuar formularin e regjistrimit dhe e dorëzon atë tek punonjësi i bankës. Banka mund ta kryejë regjistrimin e përdoruesve në disa mënyra, në varësi të faktit nëse përdoruesi është i regjistruar më parë në ndonjërin nga aplikimet e Credins online (Personale/Bizneseve apo Web). Situatat në vijim janë të mundshme:

- Përdoruesi është duke përdorur ndonjërin nga shërbimet e Credins online. Kjo do të thotë që llogaria e përdoruesit tashmë është e regjistruar në sistemin Credins online, dhe nevojitet vetëm një regjistrim për ta përdorur aplikimin Credins online SMS.
- Përdoruesi dëshiron të shfrytëzojë Credins online SMS dhe të paktën njërin nga produktet e tjera (Web, Personale, Bizneseve). Kjo do të thotë që përdoruesi duhet të plotësojë formularët e regjistrimit për Credins online, për përdorimin e shërbimeve (Web/Personale/Bizneseve) dhe Credins online SMS.
- Përdoruesi dëshiron të shfrytëzojë vetëm Credins online SMS. Në këtë rast është i nevojshëm regjistrimi në sistemet Credins online dhe Credins online SMS.

2.4 Ndryshimi i parametrave të shërbimit Credins online SMS

Përdoruesi i plotëson ndryshimet në formularin të cilin e merr nga banka.

2.5 Çregjistrimi nga sistemi Credins CONNECT/SMS

Përdoruesi e plotëson formularin të cilin e merr nga banka.

3.0 Funksionet

3.1 Mesazhet (Alarmet)

Alarmet i përkasin grupit të funksioneve automatike që nuk iu kërkohet të ekzekutohen. Është e nevojshme vetëm të përcaktohen kushtet për shkruarjen e mesazhve. Kur këto kushte të jenë plotësuar, pëdoruesi do të marrë një SMS me informacionin mbi bilancin apo ndryshimin e bilancit. Kushtet e alarmit plotësohen në formularin i cili përmban informacionet në vijim:

- Informacionet bazë për pëdoruesin
 - Emri dhe mbiemri
 - Numri i telefonit
 - Numri i llogarisë
- Mesazhet për gjëndje mbi/nën vlerën e përcaktuar:
 - Vlera maksimale (p.sh. 10.000 LEK, pëdoruesi do të marrë mesazhin nëse gjëndja para ndryshimit ka qenë më e ulët apo e barabartë me vlerën prej 10.000 LEK, por që ka tejkaluar vlerën prej 10.000 LEK pas ndryshimit)
 - Vlera minimale (p.sh. 1.000 LEK – pëdoruesi do të merr mesazh nëse gjëndja para ndryshimit ka qenë më e lartë ose e barabartë me vlerën prej 1.000 LEK, por është zvogëluar nën vlerën prej 1.000 LEK pas ndryshimit)
- Mesazhet për hyrjet/daljet më të larta se vlera e përcaktuar:
 - Vlera e përcaktuar për hyrjet (p.sh. 5.000 LEK, pëdoruesi do të marrë mesazhin për çdo hyrje e cila është më e lartë, apo e barabartë me vlerën prej 5.000 LEK)
 - Vlera e përcaktuar për dalje (p.sh. 2.000 LEK, pëdoruesi do të marrë mesazh për çdo dalje e cila është më e lartë ose e barabartë me vlerën prej 2.000 LEK)
- Mesazhi mbi gjëndjen e llogarisë në një kohë të përcaktuar:
 - Gjëndja e dërguar në një orë të caktuar (p.sh. 19:00, pëdoruesi do të marrë mesazhin SMS i cili përmban informacionin mbi gjëndjen në llogarinë e tij në çdo mbrëmje në orën 19:00)

Përveç mesazheve të konfiguruar, gjithashtu egzistojnë edhe mesazhet informative dhe promovionale (këto mesazhe nuk janë të konfiguruar nga pëdoruesi, ato janë të krijuara dhe dërguara nga banka për të informuar pëdoruesit lidhur me ndryshimet e rëndësishme, oferta të ndryshme bankare, etj.)

Përmbajtja e mesazhve SMS të pranuar nga përdoruesi është si në vijim:

- **Gjendja mbi/nën** – përdoruesi pranon informacionet mbi gjëndjen, llogarinë dhe kohën e pranimit të mesazhit:



Figura 01: ALARMI - Gjendja mbi 10.000 LEK

- **Hyrjet mbi vlerën e përcaktuar**



Figura 02: ALARMI - Hyrjet mbi 5.000 LEK

- **Daljet mbi vlerën e përcaktuar:**



Figura 03: ALARMI – Daljet mbi 1.000 LEK

➤ **Informacionet mbi gjëndjen në një kohë të përcaktuar:**



Figura 04: ALARMI - Gjëndja në orën 16:45

3.2 Informacionet mbi gjëndjen dhe tre transaksionet e fundit

Shërbimi “Informacionet mbi gjëndjen dhe tre transaksionet e fundit” është një opsion sipas kërkesës (është e domosdoshme të kërkohet nga përdoruesi). Për ta pëdorur këtë shërbim, nuk është e nevojshme të përcaktohen informacione shtesë, mjafton të jeni të regjistruar në sistemin Credins online SMS. Informacionet e nevojshme janë:

- Të dhënat themelore për përdoruesin (të marrura nga regjistrimi):
 1. Emri dhe mbiemri,
 2. Numri i telefonit,
 3. Numri i llogarisë.
- Fjalëkalimi, i përcaktuar nga banka, që i dërgohet përdoruesit dhe tregon llojin e shërbimit (shembull: fjala “**BALANCECDIS**” tregon shërbimin “Informacionet mbi bilancin dhe tre transaksionet e fundit”).
- Përdoruesi dërgon kërkesën e saktë (fjalëkalimin)
- Banka e njej fjalëkalimin dhe dërgon përgjigjen:

Komunikimi përdorues-bankë kryhet në këtë mënyrë:



Figura 05: GJËNDJA - Përdoruesi dërgon fjalën kyçe BALANCECDIS



Figura 06: GJËNDJA – Banka i përgjigjet kërkesës së saktë

- **Pëdoruesi dërgon kërkesën e pasaktë (fjalëkalimin):**




Figura 07: GJËNDJA - Pëdoruesi dërgon fjalëkalimin të pasaktë

- **Banka nuk e njeh fjalëkalimin:**



Figura 08: GJËNDJA – KËRKESË E PANJOHUR

- **Personi i parregjistruar dërgon kërkesën:**



Figura 09: GJËNDJA – Personi nuk është i regjistruar

- **Banka nuk i përgjigjet kësaj kërkesë**




Figura 10: GJËNDJA - Personi i parregjistruar